



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-008

Prishtinë, më 29 nëntor 2017, në orën 16:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 NËNTOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Sinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Sasha Milosavljeviq, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me caktimin e datës për mbajtjen e seancës plenare dhe rendin e ditës.

Lidhur me caktimin e datës dhe rendin e ditës të seancës plenare diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; nënkryetari Kujtim Shala; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Galuk Konjufca në emër të GP të LVV-së; dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia e Kuvendit vendosi që Kuvendi gjatë javës së ardhshme t'i mbajë dy seanca plenare, si në vijim:

I. Seancë plenare të martën, më 5 dhjetor 2017, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018,*
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për financim shtesë për Projektin për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.*

II. Seancë plenare të enjten, më 7 dhjetor 2017, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021.*

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 16:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale